

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje karburanti”, i ndarë në lotë:

- Loti 1 me objekt “Blerje gazoil 10ppm”.
- Loti 2 me objekt “Blerje benzinë pa plumb”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 09100000-0, 09134000-7, 09132000-3

Vlera e fondit limit: 11 079 520 (njëmbëdhjetëmilion e shtatëdhjetenëntëmijë e pesëqindnjëzetë) lekë pa TVSH, i ndarë në lotë:

- Loti 1 me fond limit 10 182 400 (dhjetëmilion e njëqindtetëdhjetedymijë e katërqind) lekë pa TVSH.
- Loti 2 me fond limit 897 120 (tetëqindnëntëdhjeteshtatëmijë e njëqindnjëzetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Ky kriter synon të sigurojë që çdo operator ekonomik të konfirmojë paraprakisht, nën përgjegjësi ligjore, përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik. Përmes vetëdeklarimit mundësohet një zhvillim më efikas i procedurës së vlerësimit të ofertave, duke shmangur ngarkesën administrative të paraqitjes së menjëhershme të dokumentacionit të plotë nga të gjithë ofertuesit, ndërkohë që autoriteti kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar dhe verifikuar dokumentacionin provues përkatës në fazat e mëvonshme të procedurës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/b dhe nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar sa vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b ku përcaktohet se: “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar...*”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024 dhe 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa*

konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën sa 35 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 35 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është mbi kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme

për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e stacioneve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë në Bashkinë Himarë të ketë të paktën 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve sipas Tabelës nr.1;

Operatori ekonomik duhet të paraqes listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë që operojnë në bashkinë Himarë si dhe personin e kontakti sipas tabelës:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Himarë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Emri i pikës		
2	*Etj.		

Etj- Nënkupton të gjitha stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

Dokumentacioni provues që duhet të paraqitet:

- Për stacionet në pronësi: dokumentacion që vërteton pronësinë dhe/ose regjistrimin e tyre në ekstraktin e regjistrimit tregtar të lëshuar nga QKB;
- Për stacionet në përdorim: kontrata noteriale qiraje dhe/ose kontrata furnizimi të vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar. Kriteri i kërkuar për paraqitjen e listës së stacioneve të karburantit në pronësi ose me qira në Bashkinë Himarë është vendosur për të siguruar ofrimin e shërbimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor. Ky kriter garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin logjistik dhe disponon infrastrukturën e nevojshme për furnizimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë të karburanteve, duke përfshirë së paku një stacion të shitjes me pakicë në territorin e Bashkisë Himarë, në përputhje me kërkesat e Tabelës nr. 1. Paraqitja e listës së detajuar të stacioneve, përfshirë adresën dhe personin kontaktues, siguron transparencë dhe mundëson verifikimin e realitetit operativ të operatorit ekonomik, duke lehtësuar procesin e monitorimit dhe kontrollit të furnizimit. Për më tepër, kërkesa që stacionet të jenë në pronësi ose të dokumentuara përmes ekstraktit të regjistrimit tregtar dhe kontratave noteriale të qiradhënies ose furnizimit, garanton legjitimitetin dhe kapacitetin ligjor të operatorit ekonomik për ofrimin e shërbimit.

2.3.3 Fletë analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve ne fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë

pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm. Kriteri që kërkon paraqitjen e fletëve të analizës të lëshuara nga ISHTI për zërat ku operatori ekonomik është i akredituar, brenda gjashtë muajve nga data e hapjes së ofertave dhe sipas standardeve në fuqi, është vendosur për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Ky kriter siguron që operatori ekonomik ka aftësitë teknike dhe laboratorike për kryerjen e analizave të nevojshme, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit, dhe se rezultatet janë të vlefshme dhe të azhurnuara. Fletët e analizës shërbejnë si provë e kapacitetit teknik dhe e përputhshmërisë me kërkesat ligjore, duke mundësuar verifikimin e aftësisë së operatorit për të ofruar shërbime laboratorike të saktë dhe të besueshme. Ky kriter teknik është i domosdoshëm për të garantuar besueshmërinë e rezultateve dhe për të minimizuar rreziqet që lidhen me shërbime të pasigurta ose të paplotësuara sipas standardeve profesionale.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar ku parashikohet se "Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete përgjate vitit 2025. Kriteri që kërkon paraqitjen e një vërtetimi të lëshuar nga ISHTI, i cili vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë gjatë vitit 2025, është vendosur për të garantuar cilësinë dhe ligjshmërinë e aktivitetit të tregtimit të karburanteve nga operatori ekonomik. Ky vërtetim shërben si provë e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale, duke demonstruar që subjekti ka operuar sipas rregullave dhe nuk ka shkelur normat e cilësisë. Përmes këtij kriteri sigurohet që furnizimi i karburanteve për autoritetin kontraktor të jetë i besueshëm, i sigurt dhe në përputhje me praktikat më të mira të tregtimit, duke minimizuar rreziqet e ndërprerjes ose ofrimit të produkteve të paqëndrueshme. Ky kriter është thelbësor për vlerësimin e kapaciteteve të operatorit ekonomik dhe për garantimin e një shërbimi profesional dhe të qëndrueshëm për vitin e kontraktimit.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhtë:

- *Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.*
- *Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.*
- *Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit në lëng me bot, deri në*

përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës. Për arsye të sasisë që duhet për mjetet e rënda të ndërrmarrjes duhet furnizim edhe në tollona.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të VKM Nr. 561, datë 29.7.2016 Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Karta elektronike përfshin identifikimin e mjetit, kontrollin e sasisë dhe gjurmueshmerinë e furnizimit të mjetit. Identifikimin e mjetit dhe transparencës së lëvritit të sasive të karburantit.

Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara më lart. Kriteri që kërkon paraqitjen e deklaratave nga subjekti ofertues, në të cilat ai merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes me pakicë me shërbim 24 orë, furnizimin me karburant përmes pistoletës publike dhe konvertimin e të gjithë sasive të litrave në karta elektronike të personalizuar për mjetet e autoritetit kontraktor, është vendosur për të garantuar një nivel të lartë operativ dhe teknik të shërbimit të karburantit. Ky kriter siguron që operatori ekonomik është i gatshëm të përmbushë kërkesat e veçanta të autoritetit kontraktor në lidhje me kohën, mënyrën dhe dokumentimin e furnizimit, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë së kartave elektronike pa afat skadence për monitorim dhe kontroll të sasisë së karburantit. Përmes këtij mekanizmi mundësohet transparencë, gjurmueshmëri dhe saktësi në shpërndarjen e karburantit, duke minimizuar rreziqet e abuzimeve ose mosrealizimit të nevojave operative. Ky kriter është thelbësor për sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm, të saktë dhe të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke reflektuar kapacitetin e operatorit për t’iu përgjigjur kërkesave specifike të autoritetit kontraktor.

Kriteri që kërkon nga subjekti ekonomik të deklarojë marrjen përsipër të konvertimit të sasisë së litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit në furnizim fizik me lëndë djegëse (me bot), si dhe përdorimin e kartave elektronike pa afat skadence deri në përfundimin e kontratës, vendoset për të garantuar efikasitetin operacional, fleksibilitetin në furnizim dhe siguri në menaxhimin e karburantit të institucionit.

Së pari, përdorimi i kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit mundëson kontroll më të mirë të konsumit të karburantit, gjurmueshmëri të furnizimeve dhe transparencë në përdorimin e fondeve publike. Kjo metodë shmang keqpërdorimet e mundshme dhe siguron që karburanti të përdoret vetëm nga mjetet e autorizuara të autoritetit kontraktor.

Së dyti, kërkesa që subjekti ekonomik të konvertojë sasinë e litrave të regjistruara në kartë në furnizim fizik me bot sipas nevojave të autoritetit kontraktor është e domosdoshme për të garantuar vazhdimësinë e operacioneve. Në praktikë, institucionet publike disponojnë mjete dhe pajisje që nuk mund të furnizohen gjithmonë në pika karburanti, por kërkojnë furnizim direkt në vendndodhjen e tyre. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të ketë kapacitet logjistik për të realizuar furnizime alternative.

Së treti, mosvendosja e afatit të skadencës për kartat elektronike deri në përfundimin e kontratës është e rëndësishme për të shmangur kufizimet administrative dhe teknike që mund të çojnë në

blokim të furnizimit ose në humbje të sasisë së parapaguar të karburantit. Kjo garanton që sasia e kontraktuar të jetë e disponueshme gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Gjithashtu, duke qenë se ndërmarrja disponon mjete të rënda, të cilat kanë konsum të lartë dhe kapacitete të mëdha rezervuarësh, është e nevojshme që furnizimi të realizohet edhe nëpërmjet tollonave. Kjo formë furnizimi krijon fleksibilitet në situata operative kur përdorimi i kartës elektronike mund të mos jetë praktik ose i mundur. Në këtë mënyrë, ky kriter kualifikimi synon të sigurojë që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë kapacitetin teknik, logjistik dhe administrativ për të përmbushur në mënyrë të vazhdueshme dhe të besueshme nevojat e autoritetit kontraktor për furnizim me karburant gjatë gjithë periudhës së kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke iu referuar katalogut të standarteve “Blerje karburanti, me perjashtim të vajgurit, Jet A1 dhe karburantit që prokurohet nga fermerët”, bashkëlidhur procedurës së prokurimit.

Standartet e paraqitura në katalogun e sipërcituar janë standarte të blera nga ana e Organit Qendror Bleres prej Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) si Organi Kombëtar i Standardizimit në Republikën e Shqipërisë. DPS-ja ka detyrimin të adoptojë si standarte shqiptare (SSH) standartet europiane në mënyrë identike dhe pa ndryshime në tekstin origjinal. Si rrjedhim, referencat e normativave në përmbajtje të standartit janë pjesë e tekstit origjinal të standarteve të huaja dhe për këtë arsye nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime. Për sa me lart, duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në brendësi të standarteve që shet, as AK në rolin e blerësit nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime. Në këto kushte sqarojmë se për çdo standart të përmendur në brendësi të çdo standarti kryesor lejohet paraqitja e ekuivalentit të tij, qoftë ai dhe Standarti Shqiptar (SSH).

Loti 1 me objekt “Blerje gazoil 10ppm”

Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 590:2022/ SSH EN 590:2025/ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Loti 2 me objekt “Blerje benzinë pa plumb”

Benzina (Premium Unl 10 ppm) duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 228:2012 + A1:2017/ SSH EN 228:2025/ekuivalent, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Për më shumë referojuni katalogut të standarteve “Blerje karburanti, me perjashtim të vajgurit, Jet A1 dhe karburantit që prokurohet nga fermerët”, bashkëlidhur procedurës së prokurimit.

Shënim: Për çdo standart ose emërtim marke të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

NJËSIA E PROKURIMIT